

Korrelacionet e shkathtësive në mes të metodës së Komunikimit dhe metodës Angazho-Studio-Aktivizo në shkollat e Kosovës

*Hysen Kasumi**

Abstrakt

Pothuajse të gjitha metodat e mësimdhënies së gjuhës angleze vënë në plan të parë performancën e nxënësve. Si pjesë e performancës së nxënësve janë gjithashtu aftësitë të tilla si: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit. Disa metoda i kushtojnë vëmendje më shumë leximit dhe shkrimit, ndërsa disa të tjera si Metoda e Komunikimit i kushton më shumë vëmendje komunikimit (të folurit). Në këtë hulumtim u testuan nxënësit e shkollave të mesme, respektivisht nxënësit e klasave të dhjeta të Kosovës, me qëllim që të marrim informacion mbi korrelacionin midis variablave (shkathtësive) për nxënësit që mësohen me metodën ESA dhe me nxënësit që mësohen me CLT (të komunikimit). Në të njëjtën kohë, gjithashtu është parë se cilat janë shkathtësitë ku studentët treguan rezultate më të mira duke përdorur metodat e lartpërmendura të mësimdhënies së gjuhës angleze.

Fjalë kyç: *shkathtësi, metodë e komunikimit, metodë angazho-studio-aktivizo, korrelacione, performancë e nxënësve.*

Hyrje

Brenda programit të kornizës më të gjerë të Kurrikulës, programet e hartuara nga mësuesit janë të hartuara për nevojat e mësimdhënësve. Kurrikula mund të përdoret nga mësimdhënësi për ta drejtuar atë drejtpërdrejt në përzgjedhjen e materialeve

* Dr. Hysen Kasumi, Kolegji AAB. E-mail: hysen.kasumi@aab-edu.net

dhe përgatitjen e një planprogrami në detaje për të arritur qëllimet e tij drejt një performance më të mirë të nxënësve të tyre. Sipas Kurrikulës së Kosovës, librat mund të dizajnohen individualisht për qëllime të shkollës ose klasës, duke marrë parasysh kushtet specifike, nevojat dhe rrethanat e klasës¹.

Kurrikula e Anglishtes në Kosovë sugjeron që mësuesit duhet të përdorin dy metoda kryesore të mësimit të gjuhës angleze: Metodën e Komunikimit dhe të mësuarit duke bërë (Learning by Doing). Megjithatë, MASHT shpërndan libra falas për lëndën e gjuhës angleze për të gjitha nivelet e mësimdhënies së gjuhës angleze. Kjo do të thotë se metoda që përdoret nga librat është metoda *Angazho-Studio-Aktivizo*.

Është kryer një hulumtim për të parë se si përdoren dy metodat e mësipërme, dhe në të njëjtën kohë, se cili ishte korrelacioni midis shkathtësive të përdorura nga këto metoda.

Për më tepër, ne synojmë të shohim nëse ka ndonjë dallim në mes të dy metodave të mësipërme në lidhje me korrelacionet në mes shkathtësive.

Metodat e mësimdhënies

Metodës së Komunikimit (CLT) i është dhënë një set prirjesh jo vetëm çfarë t'i mësojmë, por edhe se si t'i mësojmë. Se çfarë t'i mësojmë thekson funksionet gjuhësore duke u fokusuar më shumë në gramatikën dhe fjalorin. Aspekti i "Si t'i mësojmë" me MK ka të bëjë me ekspozimin e gjuhës në mënyrë që të jetë në gjendje ta përdorë atë në mundësi të ndryshme dhe gjithashtu të

¹ MEST. "http://masht.rks-gov.net/en." <http://masht.rks-gov.net/en/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>. 10 2015. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/10/ang-working-3-masht.pdf>.

zhvillojë njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve². Me fjalë të tjera, MK përfshin studentët në komunikim real dhe zhvillon aftësitë e të folurit të studentëve. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se shkathtësitë tjera nuk janë të rëndësishme për MK-në. Studentët punojnë me të katër shkathtësitë. Ashtu sikur se komunikimi që duket se ndodhë midis folësit dhe dëgjuesit, ashtu edhe kuptimi i mendimit rrjedh nga fjala e shkruar nëpërmjet një ndërveprimi midis lexuesit dhe shkrimtarit³.

Angazho-Studio-Aktivizo (ESA) është një metodë që mund të jetë e pranishme në çdo sekuencë të mësimdhënies, qoftë pesëdhjetë apo njëqind minuta. Në fazën e aktivizimit, nxënësit inkurajohen të përdorin gjuhën në tërësi dhe çfarëdo fjale të gjuhës që ata dinë. Aktivitetet komunikuese (shkathtësitë) janë dizajnuar për të aktivizuar njohuritë gjuhësore të nxënësve, kështu që janë edhe aktivitetet e leximit edhe të dëgjimit (shkathtësitë)².

Shkathtësitë e gjuhës

Ka katër shkathtësi gjuhësore: të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit. Të gjitha këto janë të rëndësishme dhe të gjitha duhet të mësohen. Pasi që ekzaminimet zakonisht testojnë vetëm leximin dhe shkrimin, aftësitë e të folurit dhe të dëgjuarit shpesh harrohen ose u jepet shumë pak kohë mësimore⁴. Mësuesi duhet të sigurohet që të gjitha katër aftësitë të mësohen dhe të mbështesin njëri-tjetrin në të gjitha pjesët e konceptit të

² Harmer, Jeremy. *The Practice of English Language Teaching*. Cambridge: Longman, 2003, (p; 84,199,200)

³ Larsen-Freeman, Diane. *Techniques and Principles in Language Teaching*. Oxford: Oxford University Press, 2003.

⁴ Sesnan, Barry. *How to Teach English*. Hong Kong: Oxford University Press, 1997.

shkathësive të integruara të gjuhës angleze. Disa metoda i japin përparësi të lexuarit dhe të shkruarit, ndërsa disa të tjera të folurit dhe të dëgjuarit. Megjithatë, në fund të fundit, të gjitha metodat kanë vetëm një qëllim, dhe kjo është mënyra se si të arrihet performanca / rezultati më i mirë i nxënësit.

Shkathësitë perceptuese

Shkathësitë perceptuese janë mënyrat në të cilat njerëzit nxjerrin kuptimin nga diskursi që shohin ose dëgjojnë. Ka përgjithësi në lidhje me këtë lloj përpunimi që aplikohet në të dy shkathësitë, të lexuarit dhe të dëgjuarit. Megjithatë, ekzistojnë gjithashtu dallime të rëndësishme midis këtyre dy aftësive². Për shembull, leximi i shenjave, telefonimi një kompanie mbështetëse teknike për kompjuterin ose lavatriçen tonë, leximi i udhëzimeve, dëgjimi i një këshilltari të konsumatorëve etj. Pra, lloji i leximit ose i dëgimit, ndodh pasi të kemi në mend një lloj qëllimi utilitar ose instrumental. Megjithatë, mund të jetë gjithashtu edhe i pëlqyeshëm. Të lexuarit e teksteve të historisë, ose të shkruarit në leksionet e historisë.

Shkathësitë produktive

Edhe pse, të ndryshëm në mënyra, shkrimi dhe të folurit janë proceset e prodhimit të gjuhës që duhet të kalojnë në cilindo medium në të cilin punojmë².

Në mënyrë që të komunikojmë me sukses ne duhet ta strukturojmë diskursin tonë në mënyrë që të jetë i kuptueshëm nga dëguesi ose lexuesi ynë. Në fjalim kjo shpesh përfshin modele biseduese dhe përdor frazat e ndryshme leksikore. Në përgjithësi, gjenden më pak fraza formulash me shkrim në

krahasim me të folurit dhe kjo është arsyeja pse shkrimi është koherent dhe koheziv. Për më tepër, edhe pse fjalimi spontan mund të jetë më kaotik dhe i çorganizuar sesa shkrimi, folësi përdor shumë struktura nga strukturat që "blejnë kohë" te shënuesit specifikë si *së pari, së dyti, në fund*" etj.

Metodologjia e hulumtimit

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje kërkimore, ne kemi përdorur një metodë vëzhgimi, e cila lejoi vëzhgimin e zbatimit të MK-së dhe ASA-s në klasa. Kemi kryer eksperimente në shkollat publike nëpër rajonet urbane dhe rurale në Kosovë. Duke përdorur metodën e MK-së, të cilën e zhvilluam në një program mësimor, ne kemi qenë në gjendje të vëzhgojmë ndryshimet në performancën e nxënësve që lidhen me metodat e përdorura të MK-së dhe që u krahasua me metoda të tjera si ASA. Një mostër prej 610 të anketuarish (nxënësish) morën pjesë në eksperiment. Studimi u zhvillua në shkollën "Hivzi Sylejmani", e lokalizuar në një lokal të urbanizuar të Fushë Kosovës dhe në shkollën "Ulpiana" në periferinë rurale në Gadime-Lipjan.

Në fund të vitit akademik, njohuritë e nxënësve vlerësohen me anë të PET (Preliminary English Test), si dhe është parë korrelacioni ndërmjet shkathtësive të MK-së dhe ASA.

Interpretimi i korrelacioneve - me testin PET

Duke iu referuar statistikave të tab. 1, ne kemi të dhëna që kanë të bëjnë me korrelacionet (ndërlidhjet) në mes të variablave për katër shkathtësitë e gjuhës angleze për grupet e kontrollit PET urban. Ne mund të konstatojmë se validiteti i korrelacioneve që

bazohet në numrin e rasteve, është statistikisht signifikant për mostrën e respondentëve 227, me nivel të besueshmërisë .05, ku çdo vlerë është më e madhe se $N(227) = .256$, dhe $p < .05$. Në anën tjetër, .01 mund të numërohet si nivel i besueshëm ku $N(227) = 354$ dhe $p < .015$. Këto korrelacione tregohen në Tabelën 1, ku ne mund të shohim se korrelacionet më të rëndësishme me besueshmëri ku ne mund të shohim se korrelacionet më të rëndësishme me besueshmëri me .01, janë ato të shkathtësive të të shkruarit dhe të dëgjuarit, ku vlera e korrelacioneve është $N(227) = 345$. Në anën tjetër, statistikatat tregojnë se korrelacionet në mes të shkathtësive tjera me besueshmëri prej $p < .05$ mund të mos jenë me signifikancë të lartë, ashtu si është në rastin tonë në mes të shkathtësisë së dëgjuarit dhe asaj të folurit ku $N(227) = 309$. Rezultatet tregojnë se nxënësit të cilëve iu ishte dhënë mësim me metodën ASA në hapësirat urbane nuk kishin korrelacion të lartë as midis shkathtësive të lexuarit dhe të folurit dhe as në mes të lexuarit dhe të shkruarit.

	Të lexuarit	Të shkruarit	Të dëgjuarit	Të folurit
Të lexuarit	1			
Të shkruarit	.012	1		
Të dëgjuarit	.061	.345**	1	
Të folurit	.233	.215	.309*	1

Tab 1. HS-PET Grupi Kontrollues.

⁵ Paul K. Strode, Ph.D., Fairview High School, Boulder, CO.

<https://www.google.com>. January 24, 2008.

[https://www.google.com/webhp?sourceid=chrome-instant&ion=1&respv=2&ie=UTF-](https://www.google.com/webhp?sourceid=chrome-instant&ion=1&respv=2&ie=UTF-8#q=the%20pearson%20productmoment%20correlation%20coefficient%20(r%20and%20linear%20regression%20(r2)%20paul%20k.%20strode%2c%20ph.d.%2c%20fairview%20high%20school%2c%20boulder%2c%20)

[8#q=the%20pearson%20productmoment%20correlation%20coefficient%20\(r%20and%20linear%20regression%20\(r2\)%20paul%20k.%20strode%2c%20ph.d.%2c%20fairview%20high%20school%2c%20boulder%2c%20](https://www.google.com/webhp?sourceid=chrome-instant&ion=1&respv=2&ie=UTF-8#q=the%20pearson%20productmoment%20correlation%20coefficient%20(r%20and%20linear%20regression%20(r2)%20paul%20k.%20strode%2c%20ph.d.%2c%20fairview%20high%20school%2c%20boulder%2c%20) (accessed March 04, 2015).

Sipas tab. 2 statistikat na japin informacion në lidhje me korrelacionin midis variablave për katër aftësitë e grupit të kontrollit të PET rural në gjuhën angleze për mostrën 77 të respondentëve, me nivelin e besueshmërisë .05, ku secila vlerë që është më e madhe se $N(77) = .304$, Me $p < .05$. Për më tepër, niveli i besueshmërisë .01 mund të llogaritet kur $N(77) = .393$, $p < .01$. Siç shihet nga tab.2 nuk ka korrelacion të rëndësishëm me nivelin e besueshmërisë .01. Kjo do të thotë se nuk ka as edhe një shkathtësi të vetme ku vlera e korrelacionit është $N(77) = .393$. Statistikat tregojnë se korrelacioni midis shkathtësive nuk është statistikisht i rëndësishëm, me $p < .05$ të besueshmërisë. Ky rezultat tregon se nuk ka një korrelacion të rëndësishëm midis rezultateve të shkathtësive të leximit dhe tek të folurit në gjuhën angleze të grupeve të kontrollit.

Vlera më e lartë e korrelacionit është realizuar në mes të shkathtësive të leximit dhe dëgjimit me $N(77) = .436$, dhe gjithashtu edhe midis të shkruarit dhe të folurit me vlerën $N(77) = .549$, por gjithmonë kur $p < .05$.

	Të lexuarit	Të shkruarit	Të dëgjuarit	Të folurit
Të lexuarit	1			
Të shkruarit	.220	1		
Të dëgjuarit	.436*	.053	1	
Të folurit	-.149	.549*	.148	1

Tab 2. ULP-PET Grupi i Kontrollit

Sipas statistikave të tab.3, ne kemi të dhëna të korrelacioneve midis variablave për katër aftësitë e gjuhës angleze për grupin eksperimental PET urbane. Ne mund të konsiderojmë se vlefshmëria e korrelacioneve në bazë të numrit të rasteve është statistikisht e rëndësishme për mostrën, 237 të respondentëve me

nivelin e besueshmërisë .05, ku secila vlerë midis shkathtësive është më e madhe se $N(237) = .256, p < .05$. Për më tepër, niveli i besueshmërisë .01 mund të llogaritet për secilën vlerë të $N(237) > .354, p < .01$ ⁵.

Korrelacionet që janë të rëndësishme në nivelin e besueshmërisë .01 janë ato midis shkathtësive të leximit dhe të dëgjimit dhe shkathtësive të të folurit, ku vlera e korrelacionit është $N(237) = .345$.

Në rastin tonë, korrelacioni në mes të shkathtësive të leximit dhe dëgjimit me vlerën $N(237) = .328$ është statistikisht i vlefshëm, me rëndësinë e besueshmërisë $p < .01$. Domethënia e njëjtë e besueshmërisë $p < .01$ do të shihet në korrelacion midis shkathtësive të leximit dhe të folurit, si dhe midis dëgjimit dhe shkrimit, si dhe atyre të dëgjimit dhe të folurit. Nga ana tjetër, statistikat tregojnë se korrelacioni ndërmjet aftësive të tjera të tilla si leximi dhe shkrimi nuk është statistikisht i rëndësishëm me $p < .05$, ku $N(237) > .309$

	Të lexuarit	Të shkruarit	Të dëgjuarit	Të folurit
Të lexuarit	1			
Të shkruarit	.218	1		
Të dëgjuarit	.328**	.537**	1	
Të folurit	.496**	.467**	.684**	1

Tab 3 . HS-PET Grupi Eksperimental

Për grupin eksperimental të grupit rural PET, mund të konsiderojmë se vlefshmëria e korrelacioneve bazuar në numrin e rasteve ka korrelacion statistikisht të rëndësishëm për mostrën e 69 të anketuarve, për nivelin e besueshmërisë .05.

Vlera e cila konsiderohet e besueshme me 0.5 është çdo vlerë që është më e madhe se $N(69) = .304$, me $p < .05$. Për më tepër,

me vlerë 0.1 e besimit mund të llogaritet ku secila vlerë N (69) = .393, me $p < .01$.

Tabela 4. tregon se nuk ka korrelacione që konsiderohen të rëndësishme me nivelin e besueshmërisë .01. Kjo do të thotë se, nuk ka shkathtësi me vlerën e korrelacionit me N (69) = .393 dhe bazuar në korrelacionin statistikor të të dhënave midis shkathtësive, ky nuk është statistikisht i rëndësishëm. Besueshmëria e disa shkathtësive është me vlerë vetëm $p < .05$.

Ky rezultat tregon se nuk ka një korrelacion të lartë midis performancës së nxënësve në shkathtësitë e të shkruarit dhe të të folurit, si dhe midis shkathtësive të të folurit dhe të dëgjimit; Për shkak të faktit se rëndësia e besueshmërisë ka vlerën e $p < .05$.

	Të lexuarit	Të shkruarit	Të dëgjuarit	Të folurit
Të lexuarit	1			
Të shkruarit	.182	1		
Të dëgjuarit	-.051	-.308	1	
Të folurit	.205	.331	.237	1

Tab 4. ULP-PET Experimental Gr.

Përfundimi

Në fillim, u mendua se MK-ja duhet të kishte korrelacion më të mirë midis shkathtësive në mësimdhënien e gjuhës angleze (MGJA) krahasuar me metodën ASA. Në fakt, në disa raste kjo edhe ndodhi, por jo në të gjitha. Ne arritëm në përfundimin se lidhjet mes shkathtësive në MGJA ishin më të mira vetëm në grupet eksperimentale urbane. Kjo do të thotë se në grupet eksperimentale rurale korrelacionet (ndërlidhjet) midis shkathtësive të MK-së ishin edhe më keq në krahasim me metodën ASA.

Ne gjithashtu mund të konkludojmë se korrelacioni mes shkathtësive nuk varet nga metoda e përdorur, por varet nga rrethanat e tjera. Një nga faktorët kyç është padyshim (variabla) mësues. Mund të shohim se në grupin eksperimental urban, ku mësuesi ishte i kualifikuar, pati një rezultat më të mirë në korrelacionet e MK-së. Sidoqoftë, në shkollat rurale, ku mësimdhënësit nuk ishin të kualifikuar, nuk kishte korrelacione midis shkathtësive në MK. Kjo është arsyeja pse ASA kishte rezultat më të mirë.

Siç kemi thënë më lart, në sekuencat tona të mësimdhënies gjithmonë duhet të ketë një shkathtësi kryesore të mësimdhënies e cila duhet të pasohet nga të paktën një nën-shkathtësi tjetër. Duket se mësuesit në zonat rurale nuk i kushtonin vëmendje planifikimit të mësimin dhe nuk e respektonin këtë rregull.

Bibliografia:

1. MEST. "http://masht.rks-gov.net/en." <http://masht.rks-gov.net/en/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>. 10 2015. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/10/ang-working-3-masht.pdf>.
2. Harmer, Jeremy. *The Practice of English Language Teaching*. Cambridge: Longman, 2003.
3. Larsen-Freeman, Diane. *Techniques and Principles in Language Teaching*. Oxford: Oxford University Press, 2003.
4. Sesnan, Barry. *How to Teach English*. Hong Kong: Oxford University Press, 1997.
5. PPaul K. Strode, Ph.D., Fairview High School, Boulder, CO. <https://www.google.com>. January 24, 2008. [https://www.google.com/webhp?sourceid=chrome-instant&ion=1&espv=2&ie=UTF-8#q=the%20pearson%20product-moment%20correlation%20coefficient%20\(r\)%20and%20linear%20regression%20\(r2\)%20paul%20k.%20strode%2c%20ph.d.%2c%20fairview%20high%20school%2c%20boulder%2c](https://www.google.com/webhp?sourceid=chrome-instant&ion=1&espv=2&ie=UTF-8#q=the%20pearson%20product-moment%20correlation%20coefficient%20(r)%20and%20linear%20regression%20(r2)%20paul%20k.%20strode%2c%20ph.d.%2c%20fairview%20high%20school%2c%20boulder%2c) (accessed March 04, 2015).

